

NJEHSIMI I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË MESME

Dokumentet e nevojshme për Njëvlefshmërisë së Diplomës së shkollës së mesme, të listuara më poshtë, duhet të dërgohen në rrugë postare ose të dorëzohen pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA):

- Formulari i aplikimit për njëvlershmëri
- Kopja e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e diplomës së shkollës së mesme.
- Kopja e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e dëftesave të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose në mungese të dëftesave, fotokopje e përkthyer dhe e noterizuar e listës së notave të arsimit të mesëm.
- Kopja e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e dokumentit që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë).

Dokumentet e paraqitura për njëvlershmëri/njehsim duhet të kenë vulën apostile të shtetit nga vijnë.

Kontaktet e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA):

- Faqja zyrtare e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA): <http://qsha.gov.al/index.html>
- Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.23, Tiranë.

Në përfundim të procedurës së Njëvlefshmërisë të diplomës së shkollës së mesme Qendra e Shërbimeve Arsimore e pajis aplikantin me dokumentin e njëvlershmërisë, ku përcaktohet edhe mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme, e njëvlerësuar.

SHËNIM: Informacioni i mësipërm bazohet në Udhëzimin nr.14 dt.10.05.2017 të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit (MASR)